

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 33, 14 – 20 Gusht 2017

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEÇ, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 33

	JAVA 33
DIARRE PA GJAK	3.964
DIARRE ME GJAK	3
INF. RESP. TE SIPËRME	5.259
INF. RESP. TE POSHTËME	1.853
RASH ME TEMPERATURË	3
VERDHËZA	0
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	0
Numri i Njësive Raportuese	390
% e Njësive Raportuese	92% (390/427)

Rash me temperaturë

2 raste janë raportuar nga rrethi i Fierit dhe 1 rast nga rrethi i Pogradecit. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rrethit, rastet nuk janë suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.


Duke u nisur nga shpërthimet epidemike të Fruthit që po ndodhin në disa shtete të Europës dhe Ballkanit, në komunikimin me epidemiologët e rretheve është theksuar përforcimi i Survejancës së sindromit “rash makulopapular me temperaturë” nga mjekët Peditër dhe Infeksionistë.

Diarre me gjak


Rastet janë te grupmoshës 1-4 vj, 5-14 vj dhe 15-44 vj te raportuara nga rrethi i Matit si “suspekt Shigelozë”. Me pas ekzaminimi rezultoi pozitiv për *Shigella sonnei* ESBL.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i “Diarre pa gjak” paraqitet i qëndrueshëm në javën e 33 krahasuar me javën paraardhëse, java e 32.

Infeksione Respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave



Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqitet i qëndrueshëm në javën e 33 krahasuar me javën paraardhëse, java e 32.

Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 20 - 33 të vitit 2016 dhe të vitit 2017. Numri i rasteve.




Në javën e 33 të vitit 2017 vërehet një trend i qëndrueshëm i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 7% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 32 dhe 33 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)



Frekuenca e hasjes së “Diarre pa Gjak” sipas grupmoshës në javën 33 të vitit 2017. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)




Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 20 - 33 të vitit 2016 dhe të vitit 2017. Numri i rasteve.



Në javën e 33 të vitit 2017 vërehet një trend i qendrueshem i numrit të rasteve të “Diarre pa gjak” dhe ky numër është 9% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 32 dhe javën 33 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)



Në javën e 33 të vitit 2017 vërehet në disa rrethe të vendit një trend në rritje të “Diarreve pa gjak” krahasuar me javën e 32.

Nga komunikimi me rrethet që kanë patur tendencë në rritje nuk janë evidentuar shpërthime Epidemike.

Nivelet e Raportimit për javën e 33 sipas rretheve, në përqindje.

